# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5736
E mërkurë, 27 mars 2019
çmimi 0.40 €


## Mbyllen lojërat e fatit për dhjetë vjet

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ FAQE 4-5

# Presim që gjykata ta hedhë poshtë vendimin për kompensimin e orëve



Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, e ka quajtur joligjor vendimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT) për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës trejavëshe. Ai ka shprehur optimizëm se Gjykata Themelore në Prishtinë do të vendosë në favor të SBAShK-ut sa i përket kompensimit të orëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jasharaj ka bërë me dije se derisa të merret ky vendim orët e humbura nuk do të kompensohen as të shtunave, as në pushimin pranveror dhe as në fund të vitit shkollor. Megjithatë, ai ka paralajmëruar se SBAShK-u do ta respektojë çfarëdo vendimi që do ta marrë gjykata

## AKTUALE

**30 VJET NGA DEMONSTRATAT MË TË PËRGJAKSHME DHE HEROIKE TË MARSIT '89** F. 11

Besart KRASNIQI

**AMBASADORI KOSNETT KËRKON PËRFAQËSIM MË TË MADH TË GRAVE NË QEVERI** F. 5

**HIQET LISTA E PRITJES PËR CT NË MUSHKËRI NË QKUK** F. 6



## TË ENJTEN BËHET BETIMI I ANËTARËVE TË RINJ TË KQZ-së

Zhbllokimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pritet të ndodhë këtë javë. Zyra e presidentit ka konfirmuar se këtë të enjte anëtarët e rinj të KQZ-së do ta bëjnë betimin para presidentit Hashim Thaçi. Njoftimi i Presidencës ka pasuar pas një deklarate të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, e cila ka shprehur shqetësim për vonesën mbi njëvjeçare për emërimin e dhjetë përfaqësuesve të KQZ-së.



Ndërsa partitë politike kanë dallime se si duhet të ndodhë përfaqësimi në këtë institucion FAQE 3



## Vonesa dhe përçarje në Kuvend për çështjen e dialogut përgjatë vitit 2018

FAQE 7

## EKONOMI

**SUBVENCIONET E DREJTPËRDREJTA TË QYMYRIT NË KOSOVË, MË TË LARTAT NË RAJON** F. 9

**GUVERNATORI MEHMETI DISKUTON ME STUDENTËT PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTORËT FINANCIARË** F. 9

## SPORT

**PRISHTINA KËRKON FITOREN E PARË NDAJ FLAMURTARIT** F. 16

**CHALLANDESI: KOSOVA NË EVROPIAN NUK ËSHTË ËNDËRR E PAMUNDUR** F. 13




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Në Beograd mbahet tubim përkujtimor për krimet ndaj shqiptarëve të Kosovës

BEOGRAD, 26 MARS - Organizatat joqeveritare "Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut" (YIHR), "Fondi për të Drejtën Humanitare" dhe "Gratë në të zeza," organizuan të martën në Beograd një tubim përkujtimor për krimet ndaj shqiptarëve të Kosovës, trupat e të cilëve janë gjetur në varrezën masive në Batajnicë të Beogradit. Këto organizata kërkojnë që shteti serb t'i zbulojë dhe t'i raportojë të dhënat për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë, e të ngrejë padi për krimet e kryera dhe fshehjen e tyre.
Aktivistët e shoqërisë civile shpalosën në kryeqytetin serb një pankartë me emrat e shqiptarëve të gjetur në Batajnicë. Ndër kërkesat e tyre është edhe ndërtimi i monumenteve për këto viktima, si dhe ndërprerja e praktikës së kthimit të kriminelëve të luftës në institucionet e vendit.




# Shqipëria i ofron mbështetje Kosovës në integrimet evropiane

Na takim me ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, homologia e tij nga Shqipëria, Etilda Gjonaj, ka ofruar mbështetjen e institucioneve të Shqipërisë në integrimet evropiane, me përvojën që kanë për përmbushjen e obligimeve të dala nga hapja e kapitujve 23 dhe 24 të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian

PRISHTINË, 26 MARS - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim ministren e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, Etilda Gjonaj. Ministri Tahiri e ka njoftuar homologen nga Shqipëria për reformat e ndërmarra që nga fillimi i mandatit të tij, nisur nga agjenda legjislative dhe ndryshimet e bëra në legjislacionin e fushës penale.
Ministri Tahiri ka potencuar punën e bërë në reformimin e drejtësisë, nisur nga Rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, proces i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë dhe me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë dhe institucioneve ndërkombëtare, që do t'i definojë vlerat, përgjegjësitë dhe mandatet që synojnë një rend juridik demokratik, të përgjegjshëm dhe efikas.
Përmirësimi i përvojës së qytetarëve me gjyqësorin, sipas ministrit Tahiri, do të arrihet përmes agjendës së përbashkët "Drejtësia 2020", që synon që për dy vjet problemet kryesore të sektorit të zgjidhen dhe të përfundojë tranzicionin në drejtësi.
Ministrja Gjonaj ka njoftuar ministrin Tahiri lidhur me zbatimin e reformave të ndërmarra në gjyqësor në Shqipëri, si dhe ka kërkuar shkëmbimin e përvojave në çështjen e ndërmjetësimit, si njëra nga mundësitë kryesore që qytetarët kanë për zgjidhjen alternative të rasteve të tyre.
Ministrja Gjonaj i bëri me dije homologut të Kosovës se "është e hapur për një bashkëpunim në të gjitha fushat, në veçanti për reformën në drejtësi, duke vendosur ura lidhëse mes organeve të reja të drejtësisë të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe për të shkëmbyer përvoja, sidomos midis këshillave të prokurorisë dhe gjyqësorit". "Dua të theksoj se partnerët tanë ndërkombëtarë po na mbështesin financiarisht dhe me ekspertizë të vyer për zbatimin e reformave", theksoi ministrja Gjonaj.



Gjithashtu, ministrja Gjonaj ka ofruar mbështetjen e institucioneve të Shqipërisë në integrimet evropiane, me përvojën që kanë për përmbushjen e obligimeve të dala nga hapja e kapitujve 23 dhe 24 të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
Në takim është diskutuar edhe për thellimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar si dhe bashkëpunimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës me institucionet korrektuese në Shqipëri.
Në fund të takimit, Gjonaj propozoi që ministrat e drejtësisë të luajnë rol proaktiv dhe të jenë promotorë të një bashkëpunimi rajonal, si një komb e dy shtete.




# Stoltenbergu: Bombardimet e NATO-s ishin të drejta

BRUKSEL, 26 MARS - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 nuk ishte e drejtuar kundër popullit të ish-Jugosllavisë, por roli i saj ishte t'i mbrojë civilët në rajon. "Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë të kaluarën, por ne mund të shkojmë më tej dhe kjo është ajo që NATO-ja dhe Serbia po bëjnë sot si partnerë", ka thënë Stoltenbergu për agjencinë serbe të lajmeve "Tanjug".
Bombardimet kundër Serbisë, të cilat i kanë dhënë fund regjimit të Sllobodan Millosheviqit, kanë zgjatur 78 dhe kanë marrë pjesë 19 vende të NATO-s.



## Cakaj spastron Ministrinë nga njerëzit e Bushatit

TIRANË, 26 MARS - Ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, bën spastrim në institucionin që ai drejton. Mbi 20 punonjës të kësaj ministrie do të largohen.
Ai tha se ka vendosur t'i shkëpusë marrëdhëniet me disa punonjës, ndërsa theksoi se numri i të prekurve mund të shkojë në 20, ndërsa njoftoi nisjen e një reforme për të larguar, sikur tha ai, nga ky shërbim të gjithë ata që nuk e meritojnë. Në një deklaratë për medie ai ka thënë se do të largohen nga puna ata që nuk i përmbushin detyrimet dhe një pjesë tjetër e punonjësve do të transferohen për nevojat reale të punës. "Ju informoj se numri i të prekurve nga kjo iniciativë informatore do të shkojë mbi 20. Agjenda reformiste e kapërcimit të pellgut të shkuar nuk përkon me nepotizmin në asnjë sektor.
Duke vlerësuar njëkohësisht hapjen e dyerve të shtetit për të rinjtë ekselentë të vendit si avantazh të madh që duhet shfrytëzuar e doemos për ta ripërtërirë administratën tonë, komunikoj se kemi gati thirrjen publike për vakancat e krijuara nga vala e pastrimit në shërbimin tonë diplomatik, Shqipëria nuk është e miqve, kushërinjve, apo klaneve e krushqive, por e të gjithëve pa dallim dhe meriton të përfaqësohet nga të dalluarit që punojnë me mendje, shpirt e shërbejnë me pasion me kapacitet të plotë profesional dhe moral", ka thënë Cakaj.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) drejt funksionalizimit

# Të enjten bëhet betimi i anëtarëve të rinj të KQZ-së

Zhbllokimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pritet të ndodhë këtë javë. Zyra e presidentit ka konfirmuar se këtë të enjte anëtarët e rinj të KQZ-së do ta bëjnë betimin para presidentit Hashim Thaçi. Njoftimi i Presidencës ka pasuar pas një deklarate të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, e cila ka shprehur shqetësim për vonesën mbi njëvjeçare për emërimin e dhjetë përfaqësuesve të KQZ-së. Ndërsa partitë politike kanë dallime se si duhet të ndodhë përfaqësimi në këtë institucion




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 MARS - Funksionalizimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) do të ndodhë këtë javë. Kështu ka bërë me dije Zyra e Presidentit e Republikës së Kosovës. Presidenca ka njoftuar se pas përmbylljes së të gjitha procedurave, këtë të enjte anëtarët e rinj të KQZ-së do ta bëjnë betimin para presidentit Hashim Thaçi. "Pas përmbylljes së të gjitha procedurave dhe kompletimit të lëndëve me informacionet e kërkuara shtesë, këtë javë do të emërohen anëtarët e rinj të KQZ-së. Anëtarët e rinj të KQZ-së, të enjten, më 28 mars 2019, do ta bëjnë betimin para presidentit Thaçi", është thënë në njoftimin e Zyrës së Presidencës.

Ky njoftim ka ardhur pak orë pasi Ambasada e ShBA-së në Prishtinë ka shprehur shqetësimin e saj për vonesën për emërimin e përfaqësuesve të partive politike në këtë institucion të pavarur. Në reagimin e Ambasadës së ShBA-së është thënë se dështimi për t'i emëruar përfaqësuesit ia ka pamundësuar KQZ-së kryerjen e funksioneve të saj themelore. "Jemi të shqetësuar me vonesën prej më shumë se një vit të emërimit të dhjetë përfaqësuesve në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). Dështimi për t'i emëruar përfaqësuesit ia ka pamundësuar KQZ-së kryerjen e funksioneve të saj themelore, më shumë se 30 anëtarë të kuvendeve komunale dhe një deputet i Kuvendit të Kosovës nuk kanë pasur mundësi ta marrin detyrën për shkak të vonesës. Ky dështim ka rritur perceptimin e publikut, madje një ndër institucionet më efikase dhe më jopartiake të Kosovës i nënshtrohet ndërhyrjes politike", është thënë në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, e cila ka kërkuar nga presidenti funksionalizim sa më të shpejtë të këtij institucioni. "E nxisim presidentin Thaçi që menjëherë t'i emërojë përfaqësuesit në KQZ për t'ia kthyer këtij institucioni aftësinë për të punuar në mënyrë të besueshme dhe të pavarur për të mirën e popullit të Kosovës", është theksuar në këtë deklaratë.

Partitë politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, më herët i kanë dërguar propozimet e tyre për anëtarë të KQZ-së te presidenti, por ende nuk dihet se si do të jetë përfaqësimi i partive politike në këtë institucion.

Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare të mbajtur për këtë çështje, e cila është mbajtur kohe më parë, partitë politike kanë shprehur qëndrime të ndryshme se si duhet të ndodhë ky përfaqësim. Të gjitha palët pretendojnë se kërkesat e tyre kanë bazë kushtetuese.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka vlerësuar se çdo grup parlamentar duhet të jetë i përfaqësuar në KQZ. Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se dispozitat kushtetuese rreth përfaqësimit të partive politike në këtë institucion janë shumë të qarta, duke shtuar se paqartësia është vetëm në kokat e atyre që po dëshirojnë ta grabisin atë që nuk u takon. "Neni 139 i Kushtetutës së Kosovës është i rezervuar për Komisionin Qendror Zgjedhor dhe i ka katër paragrafë. Në paragrafin e parë thuhet: 'Komisioni Qendror Zgjedhor është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyrë, drejton dhe verifikon të gjithë veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendume dhe shpall rezultatet e tyre'. Kur lexohet ky paragraf, i cili KQZ-së i ka dhënë mandat të përhershëm, kush i dha të drejtën kryetares së KQZ-së që këtë organ të përhershëm ta bëjë jofunksional, në kohën kur anëtarët e KQZ-së marrin paga nga buxheti i shtetit? Për këtë dikush do të duhej të përgjigjej", ka shkruar Krasniqi, duke treguar se si duhet të jetë përfaqësimi. "Kushtetuta jonë e thotë shumë qartë, në paragrafin katër: 'Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. (…)'. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, gjërat janë më shumë sesa të qarta, paqartësia është vetëm në kokat e atyre që po dëshirojnë ta grabisin atë që nuk u takon. Kjo të çon në përfundimin se grabitja po bëhet praktikë e keqe në çdo segment të jetës sonë shoqërore. Kjo praktikë nuk i duhet askujt", është shprehur Krasniqi.

Ndërsa ish-anëtari i KQZ-së nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Florian Dushi, ka vlerësuar se përfaqësimi i subjekteve politike në këtë institucion të pavarur nuk duhet të ndodhë mbi bazën e dëshirës së partive, por mbi bazën e Kushtetutës së Kosovës. Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Dushi ka thënë se presidenti i vendit, Hashim Thaçi, duhet të veprojë sipas formulës së njohur deri më tani. "Kjo nuk mund të trajtohet si dëshirë apo vullnet i subjekteve politike. Kemi tri subjekte politike që kanë dalë nga zgjedhjet e fundit nacionale: koalicionin PAN, Lëvizjen Vetëvendosje dhe koalicionin që e udhëheq LDK-ja. Kështu që, gjashtë vendet e parapara për komunitetin shumicë shqiptar në këtë institucion duhet të ndahen në mes të këtyre tri subjekteve politike, që nënkupton se secila prej tyre duhet t'i ketë nga dy përfaqësues", ka thënë Dushi.

# Mbyllen lojërat e fatit për dhjetë vjet

PRISHTINË, 26 MARS (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të martën Projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit. Sipas projektligjit, ndalohen të gjitha lojërat e fatit, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës, dhe shfuqizohet Ligji për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij. Ligji do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

Për këtë lajm, kryeministri Ramush Haradinaj ka shkruar edhe në llogarinë e vet në "Facebook". "Në mbledhjen Qeverisë është miratuar Projektligji për ndalimin e të gjitha lojërave të fatit në afat prej 10 vjetësh, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka ndarë mjete financiare për rregullimin dhe funksionimin e Shtëpisë Muze në Lagjen Lumbardhë në Mitrovicë. Gjithashtu, është themeluar Këshilli Organizativ për shënimin e 20-vjetorit të intervenimit të NATO-s në Kosovë, që do të udhëhiqet nga ish-presidentja Atifete Jahjaga, si dhe është aprovuar koncept-dokumenti për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, përkatësisht investimeve, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, kabineti qeveritar ka miratuar planin e veprimit për reformën e investimeve të Qeverisë së Kosovës.

Miratimin në parim nga kabineti qeveritar e ka marrë edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunim në politikën e jashtme.



Flet për "Epokën e re", Rrahman Jasharaj

# Presim që gjykata ta hedhë poshtë



Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, e ka quajtur joligjor vendimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT) për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës trejavëshe. Ai ka shprehur optimizëm se Gjykata Themelore në Prishtinë do të vendosë në favor të SBAShK-ut sa i përket kompensimit të orëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jasharaj ka bërë me dije se derisa të merret ky vendim orët e humbura nuk do të kompensohen as të shtunave, as në pushimin pranveror dhe as në fund të vitit shkollor. Megjithatë, ai ka paralajmëruar se SBAShK-u do ta respektojë çfarëdo vendimi që do ta marrë gjykata

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka shprehur optimizëm se Gjykata Themelore në Prishtinë do ta hedhë poshtë vendimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT) për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës trejavëshe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është joligjor vendimi për kompensimin e orëve të humbura. "Po, e kemi dërguar padinë ndaj vendimit të MAShT-it lidhur me kompensimin e orëve, sepse vendimi i tillë nuk ka bazë ligjore. SBAShK-u është i sigurt se gjykata do të sjellë vendim meritor dhe do ta hedhë poshtë vendimin e ministrit Bytyqi si të pabazuar në ligj. Pra, presim që vendimi i gjykatës të jetë në favorin tonë", është shprehur Jasharaj. Ai ka bërë me dije se derisa të merret ky vendim orët e humbura nuk do të kompensohen as të shtunave, as në pushimin pranveror dhe as në fund të vitit shkollor. Megjithatë, Jasharaj ka paralajmëruar se SBAShK-u do ta respektojë çfarëdo vendimi që do ta marrë Gjykata Themelore në Prishtinë. "Jemi në pritje të vendimit nga kjo gjykatë. Cilindo vendim që do ta sjellë gjykata ne do ta respektojmë. Por, deri atëherë orët e humbura në grevë as të shtunave, as në pushimin pranveror dhe as në fund të vitit shkollor nuk do të kompensohen", ka deklaruar Jasharaj.

Kryetari i Sindikatës së Arsimit e ka pranuar faktin se kohët e fundit janë ftohur raportet në mes të SBAShK-ut dhe MAShT-it mirëpo, sipas tij, jo me fajin e SBAShK-ut. "Fillimisht raportet kanë qenë korrekte në mes të SBAShK-ut dhe MAShT-it, mirëpo kohët e fundit janë ftohur, por jo me fajin e SBAShK-ut. Megjithatë, ne si SBAShK prapë jemi të hapur për komunikim dhe bashkëpunim, por duke pasur respekt të ndërsjellë dhe duke çmuar angazhimet e njëri-tjetrit. Edhe në të kaluarën SBAShK-u ka pasur kundërshtime dhe 'përplasje' me ministrat e arsimit, por falë angazhimeve të përbashkëta ato mosmarrëveshje tejkaloheshin në shërbim të arsimit në Kosovë", ka theksuar Jasharaj.

**"Epoka e re":** *Z. Jasharaj, SBAShK-u ka paralajmëruar grevë të përgjithshme në rast se insistohet në zëvendësimin e orëve të humbura gjatë grevës trejavëshe që është mbajtur. Pse nuk po pranoni të zëvendësohen këto orë?*

**Jasharaj:** Këshilli Drejtues i Sindikatës së Bashkuar të

# vendimin për kompensimin e orëve



Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK) edhe gjatë grevës kishte alarmuar tek institucionet që të angazhohen sa më shpejt dhe në mënyrë korrekte për të gjetur zgjidhje sepse orët e humbura gjatë grevës nuk do të kompensohen, sepse ky ishte vendim i Këshillit Drejtues të SBAShK-ut, që përfaqëson gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit, që nga çerdhet e deri tek universitetet. Edhe Ligji për grevat nuk obligon grevistët që t'i kompensojnë orët e humbura në grevë. Përveç kësaj, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, pa u konsultuar fare me SBAShK-un nxori një vendim, që nuk bazohet në ligj. Prandaj ne kemi ngritur padi ndaj këtij vendimi në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe jemi në pritje të vendimit nga kjo gjykatë. Cilindo vendim ta sjell gjykata ne do ta respektojmë. Por, deri atëherë orët e humbura në grevë as të shtunave, as në pushimin pranveror e as në fund të vitit shkollor nuk do të kompensohen.

**"Epoka e re":** *Për këtë çështje SBAShK-u i është drejtuar gjykatës me kërkesën për pezullimin e vendimit të MAShT-it, që orët mos të zëvendësohen. Çfarë vendimi prisni nga gjykata?*

**Jasharaj:** Po, e kemi dërguar padinë ndaj vendimit të MAShT-it lidhur me kompensimin e orëve, sepse vendimi i tillë nuk ka bazë ligjore. SBAShK-u është i sigurt se gjykata do të sjellë vendim meritor dhe do ta hedhë poshtë vendimin e ministrit Bytyqi si të pabazuar në ligj. Pra, presim që vendimi i gjykatës të jetë në favorin tonë.

**"Epoka e re":** *Nëse gjykata do të vendosë pro vendimit të MAShT-it, çfarë qëndrimi do të ketë SBAShK-u?*

**Jasharaj:** Po e thashë edhe më lart, Këshilli Drejtues i SBAShK-ut ka qëndrim të qartë. Cilindo vendim që ta sjellë gjykata ne do ta respektojmë.

**"Epoka e re":** *Nuk ju vjen keq nga nxënësit që në këtë rast janë humbësit më të mëdhenj, meqë mësimdhënësit, edhe pse nuk kanë mbajtur mësim, janë paguar, ndërkohë nxënësit kanë mbetur mbrapa në procesin mësimor?*

**Jasharaj:** Duke na ardhur keq për nxënësit ne jemi munduar që nga maji i vitit të kaluar që me takime dhe me dialog me institucionet të gjejmë zgjidhje dhe t'i përmirësojmë koeficientet për tërë sistemin arsimor në Ligjin e pagave. Kemi alarmuar me kohë edhe me protestën e 7 shtatorit 2018, por edhe me grevën njëorëshe më 28 dhjetor 2018, duke paralajmëruar me kohë se, nëse dialogu dhe këto angazhime nuk japin rezultate, atëherë do të shkohet me grevë të përgjithshme në tërë sistemin arsimor më 14 janar 2019 dhe ashtu ndodhi, sepse institucionet nuk reflektuan. Për nxënësit duhet t'u vijë keq institucioneve që nuk kanë kryer detyrën e tyre me kohë dhe nuk i janë qasur në mënyrë korrekte dialogut për çështjen e ngritur. SBAShK-u nuk i do grevat, por kur dialogu nuk jep rezultat, atëherë nuk na mbetet zgjidhje tjetër. Greva është mjet legjitim për t'i shprehur pakënaqësitë dhe është e mbrojtur dhe e përcaktuar edhe me Ligjin e grevave të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Cili është bashkëpunimi i SBAShK-ut me MAShT-in sepse, për dallim prej herëve të tjera, në këtë mandat qeverisës raportet SBAShK-MAShT shihet se nuk janë aq të mira?*

Jasharaj: Fillimisht raportet kanë qenë korrekte në mes të SBAShK-ut dhe MAShT-it, mirëpo kohët e fundit janë ftohur, jo me fajin e SBAShK-ut. Megjithatë, ne si SBAShK prapë jemi të hupur për komunikim dhe bashkëpunim, por duke pasur respekt të ndërsjellë dhe duke çmuar angazhimet e njëri-tjetrit. Edhe në të kaluarën SBAShK-u ka pasur kundërshtime dhe 'përplasje' me ministrat e arsimit por, falë angazhimeve të përbashkëta, ato mosmarrëveshje tejkaloheshin në shërbim të arsimit në Kosovë.



# Ambasadori Kosnett kërkon përfaqësim më të madh të grave në qeveri

**Prishtinë, 26 mars (ER)** - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë të martën se fuqizimi i grave është përgjegjësi e të gjithëve. Diplomati amerikan ka thënë se rreth 50 për qind e popullatës në Kosovë po pengohen në shoqëri, duke mos qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse.

Kosnett ka kërkuar nga kryeministrit Haradinaj që rreth 50 për qind e kabinetit qeveritar të jenë gra. "Kur njerëzit e dëgjojnë fjalën integritet mendojnë ndershmërinë, por ekziston dhe një fjalë tjetër që ka të bëjë me bashkimin, paanshmërinë dhe plotësinë. E Kosova nuk është e plotë, 50 për qind e popullatës së saj pengohet në shoqëri. Kur gratë janë pjesë e procesit vendimmarrës, rritë produktivitetin e një vendi. Kur gratë shërbejnë në qeveri, ato janë më pak të korruptuara. Gratë në Kosovë po bëjnë gjëra të mëdha", ka deklaruar ambasadori amerikan Philip Kosnett në ngjarjen vjetore "Java e Grave", e organizuar nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), me mbështetjen e USAID-it dhe Zyrës së Kryeministrit.

Në këtë aktivitet është theksuar se Kosova ka mangësi për angazhimin e grave në proceset vendimmarrëse. Por kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova ka shënuar përparim në avancimin e rolit të gruas, por si shoqëri ka ende shumë punë para vetes. Haradinaj ka deklaruar se në gjithë rrugëtimin e tij temë e posaçme, gjithmonë i është kushtuar përfaqësimit të femrës. "Kam qenë pjesë e diskutimit kur është diskutuar ideja e kuotës për përfaqësimin e femrës dhe pas një debati, pune të përbashkët, kuota e përfaqësimit është kthyer në një normë", ka theksuar ai, duke shtuar se janë hequr shumë tema tabu që kanë ekzistuar por, megjithatë, sipas Haradinajt, në pjesën rurale është çështja e trashëgimisë, ku numri i femrave që kanë posedim një pronë ose që marrin trashëgimi prej prindërve nuk është sa e djemve. "Në plot rrafshe, drejtime, Kosova nuk bën përjashtim nga popujt, shoqëritë euroatlantike. Në zhvillimin tonë të brendshëm, pozicioni, liria gjinore, mendojmë që ka shënuar progres", është shprehur ai.

Kurse koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë se përfaqësimi i drejtë i grave është parakusht për zhvillim dhe demokraci. Ai ka theksuar se institucionet, partnerët ndërkombëtarë dhe vetë shoqëria duhet të ndërmarrim nisma më të gjëra për demokratizimin e subjekteve politike. "Pra, sa më demokratike, më profesionale dhe më gjithëpërfshirëse t'i kemi partitë politike, aq më shumë do të kemi qeverisje të mirë, përfaqësim të barabartë në institucione", ka deklaruar Tahiri.

# Hiqet lista e pritjes për CT në mushkëri në QKUK

Pas një kohe të gjatë, me aktivizimin e shërbimeve para dhe pasdite, është hequr edhe lista e pritjes për CT në mushkëri, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Me këtë marrin fund pritjet e qytetarëve deri në dy muaj për një tomografi që t'i diagnostikojë shkaqet e shqetësimeve të tyre



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 MARS - Lista e Pritjes për Tomografi të Kompjuterizuar (CT) në mushkëri, pas një kohe të gjatë, me aktivizimin e shërbimeve para dhe pasdite, është hequr. Më herët, qytetarët kanë pritur deri në dy muaj t'i diagnostikojnë shkaqet e shqetësimit të tyre, një kohë e gjatë që e ka shtyrë trajtimin, duke ndërlikuar procesin e shërimit.
Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se me këtë marrin fund pritjet e qytetarëve deri në dy muaj për një tomografi që t'i diagnostikojë shkaqet e shqetësimeve të tyre. "Kjo do ta shkurtojë edhe kohën e qëndrimit të pacientit në spital dhe do t'i mbrojë ata nga shpenzimet e larta financiare", ka thënë ministri Ismaili.
Ndërkaq drejtoresha e Klinikës së Pulmologjisë, Rukije Mehmeti, ka thënë se puna me dy ndërrime ka mundësuar që pacientët ta marrin shërbimin brenda dy ditëve më së gjati. "Kjo me të vërtetë e shkurton edhe kohën e qëndrimit të pacientit në spital, edhe harxhimet. Kur të mendohet për hospitalizimin e një pacienti duhet të mendohet jo vetëm shtrirja e tij dhe diagnoza, por edhe koha e qëndrimit. Pacienti është dashur të qëndrojë deri në dy muaj për ta marrë rezultatin e CT-së. Tash CT-të realizohen shumë shpejt dhe koha e qëndrimit të pacientit në spital shkurtohet shumë", ka thënë Mehmeti.
Drejtori i Radiologjisë, Bujar Gjikolli, ka thënë se me angazhimin e stafit mjekësor, Lista e Pritjes për këtë shërbim është hequr. Sipas tij, më nuk ka pacientë që presin për CT në mushkëri. "Me përkrahjen e stafit mjekësor, kemi marrë vendim që ta lëshojmë edhe ndërrimin e pasdites për tomografi të kompjuterizuar, ku Klinikës së Pulmologjisë ia kemi dhënë mundësinë të sjellë pacientë edhe pasdite, në mënyrë që t'u përgjigjen të gjitha rasteve, por edhe me qëllim që ta sjellim listën në zero", ka theksuar Gjikolli.
Gjatë dy muajve të parë të këtij viti në QKUK janë kryer 130 tomografi të kompjuterizuara për mushkëri. Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar po angazhohen që gjatë këtij viti të hiqen listat e pritjes edhe për shërbimet e tjera që ofrohen në QKUK.

# MAShT-i me përgatitje intensive për testin ndërkombëtar TIMSS

PRISHTINË, 26 MARS (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, mori pjesë të martën në takimin e përbashkët të Komisionit për Vlerësime Ndërkombëtar, përfaqësuesve të drejtorive komunale të arsimit dhe koordinatorëve të shkollave të përzgjedhura për vlerësimin TIMSS, ku u bisedua për përgatitjet rreth mbarëvajtjes së këtij testi vlerësues.
Ministri Bytyqi me këtë rast vlerësoi lart rëndësinë e testit TIMSS, i cili mbështet nga partnerët tanë, si një instrument i jashtëm vlerësues, nga rezultatet e të cilit do të kemi një pasqyrë reale të gjendjes në sistemin e arsimit në Kosovë.
Ministri Bytyqi kërkoi nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces që të angazhohen maksimalisht, t'i informojnë nxënësit dhe shkollat pjesëmarrëse që të jenë të përgatitur dhe ta japin maksimumin. Në këtë kontekst, ministri Bytyqi kërkoi nga Komisioni për Vlerësim dhe të tjerët që të zhvillohen sa më shumë vizita në terren me qëllim të vetëdijesimit për rëndësinë e këtij testi vlerësues ndërkombëtar dhe shtoi se praktika e fundit me testin PISA tregoi se një qasje e tillë pa dyshim jep rezultate të mira.



Testi ndërkombëtar (hulumtimi) TIMSS është vlerësim ndërkombëtar i trendëve në njohuritë e Matematikës dhe Shkencave Natyrore, i cili realizohet në kuadër të organizatës IEA (Internacional Association for dhe Evaluation of Edukational) për vlerësimin e të arriturave në arsim. Ndryshe, MAShT-i, përkatësisht Divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Standardeve dhe Monitorim, ka hartuar planin dinamik të organizimit, në harmoni me kërkesat e parashtruara. Janë përzgjedhur 148 shkolla, prej të cilave tri shkolla janë më nxënës me nevoja të veçanta. Testi ndërkombëtar TIMSS përfshinë nxënësit e klasave të katërta dhe teta, me gjithsej rreth 5 000 nxënës dhe fillon nga data 22 prill - 10 maj 2019. Ky proces vlerësues mbështet nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore (projekti KESIP) dhe partnerë të tjerë të MAShT-it.

## Policia e Kosovës ndan mirënjohje për drejtorin e ShSKUK-së, Basri Sejdiu




PRISHTINË, 26 MARS (ER) - Policia e Kosovës (PK) të martën ka nderuar me mirënjohje drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu. Mirënjohja është ndarë për kontributin e dhënë për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

# Vonesa dhe përçarje në Kuvend për çështjen e dialogut përgjatë vitit 2018

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar raportin mbi atë se si dhe sa e ka trajtuar Kuvendi i Kosovës dialogun Kosovë - Serbi gjatë vitit 2018. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë diskutuar lidhur me dialogun në 21 nga 42 seancat e mbajtura përgjatë vitit 2018, në të cilat temat më të diskutuara ishin ideja e korrigjimit të kufijve, faza e re e dialogut, ekipi negociator, taksa prej 100 përqindësh, personat e pagjetur, si dhe zbatimi i marrëveshjes për energjinë




EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 26 mars - Të martën, gjatë tryezës së diskutimit "Si të bëhet më efektive mbikëqyrja parlamentare ndaj dialogut Kosovë - Serbi?", Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar raportin mbi atë se si dhe sa e ka trajtuar Kuvendi i Kosovës dialogun Kosovë - Serbi gjatë vitit 2018. Të pranishëm në këtë tryezë ishin deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe anëtarë të shoqërisë civile.

Violeta Haxholli nga KDI-ja gjatë prezantimit të të gjeturave kryesore të këtij raporti ka theksuar se çështjet e dialogut Kuvendi i ka trajtuar në seanca më shumë gjatë sesionit vjeshtor, ndërsa gjatë sesionit pranveror dialogu është zhvilluar kryesisht në kuadër të mbledhjeve të komisioneve parlamentare. "Procesi i dialogut gjatë pjesës së parë të vitit është zhvilluar në nivel teknik. Fokusi i deputetëve ka qenë mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjeve dhe diskutimet se kush duhet ta udhëheqë këtë proces. Në pjesën e dytë të vitit, për shkak të zhvillimeve politike, fokusi ka qenë te tema e ' korrigjimit të kufijve' dhe delegacioni shtetëror e cila vuri në pah ndasitë në mes të partive parlamentare", ka potencuar Haxholli.

Ajo ka shtuar se deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë diskutuar lidhur me dialogun në 21 nga 42 seancat e mbajtura përgjatë vitit 2018, në të cilat temat më të diskutuara ishin ideja e korrigjimit të kufijve, faza e re e dialogut, ekipi negociator, taksa prej 100 përqindësh, personat e pagjetur si dhe zbatimi i marrëveshjes për energjinë.

Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare të procesit të dialogut, Haxholli ka potencuar se ky funksion nuk është ushtruar sa duhet nga ana e deputetëve, të cilët kanë parashtruar vetëm nëntë pyetje parlamentare lidhur me dialogun, nga gjithsej 275 sa janë parashtruar në përgjithësi si dhe kanë iniciuar vetëm një interpelancë, nga 12 sosh sa janë iniciuar në përgjithësi.

Në raport me debatet parlamentare, si mekanizëm tjetër për mbikëqyrjen e procesit të dialogut ajo bëri me dije se janë iniciuar vetëm tri debate parlamentare. Janë miratuar edhe tre rezoluta: ajo për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ajo për personat e pagjetur dhe ajo për mjetet e ndara nga Qeveria e Kosovës për energjinë elektrike të shpenzuar në veri të vendit.

Gjithsesi, dialogu Kosovë - Serbi ka ndikuar drejtpërsëdrejti në punën dhe funksionimin e Kuvendit. Pikëpamjet e ndryshme të subjekteve mbi të ardhmen e këtij procesi ndikuan në thellimin e përçarjeve ndërmjet pozitës dhe opozitës. Kjo u përcoll me instalimin e praktikave të bojkotit dhe u pamundësua kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

Haxholli, duke folur për punën e komisioneve parlamentare në raport me procesin e dialogut, bëri me dije se temat e ndërlidhura me dialogun janë ngritur në 10 për qind të mbledhjeve të mbajtura nga komisionet parlamentare.

Temat më të diskutuara ishin: zbatimi i marrëveshjeve të deritanishme, lobimi i Serbisë kundër Kosovës, vizitat e zyrtarëve serbë në Kosovë dhe fati i personave të pagjetur. "Tri komisionet parlamentare të cilat kanë diskutuar më së shumti rreth dialogut janë: Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione", ka thënë ajo.

Puna e Kuvendit për vitin 2018 u përmbyll me miratimin e Rezolutës mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 15 dhjetor e cila u votua nga 59 deputetë, ndryshe nga pritjet e qytetarëve për delegacion të gjerë politik, të dala nga sondazhet e KDI-së.

Në anën tjetër, deputetët nga pozita dhe opozita vlerësuan se Kuvendi ka luajtur një rol relativisht të mirë në trajtimin e çështjes së dialogut. Ata theksuan nevojën për arritje të një konsensusi të spektrit politik lidhur me çështjen e dialogut dhe u pajtuan se Kuvendi duhet të vazhdojë ta luajë rolin mbikëqyrës në fazën e re të dialogut.

# Ministrja Hoxha: BE-ja mbetet adresa jonë e vetme




**Prishtinë, 26 mars (ER)** - Në tryezën me temë "Rruga e Kosovës në integrimin evropian nga pikëvështrimi i treshes së Presidencës së Këshillit të BE-së", me praninë e ambasadorëve të Kroacisë, Finlandës dhe Rumanisë, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka vlerësuar vendimmarrjen e tyre.

Organizatorë të kësaj tryeze diskutimi janë misionet diplomatike të treshes kryesuese të Këshillit të BE-së, përkatësisht Ambasada e Kroacisë, Ambasada e Finlandës dhe Zyra Ndërlidhëse e Rumanisë në Kosovë, në bashkëpunim me Grupin për Studime Ligjore dhe Politike.

Në këtë tryezë, së bashku me ambasadoren Maria Kapitanoviq, ambasadoren Pia Stjernvall, Daniel Oni?or si dhe mysafirë të tjerë, u diskutua për arritjet, sfidat dhe rrugën e Kosovës drejt integrimit në BE. "BE-ja mbetet adresa jonë e vetme për paqe të qëndrueshme, prosperitet dhe mundësi të barabarta për qytetarët tanë. Nga Presidenca e Këshillit të BE-së, dhe nga BE-ja në përgjithësi, ne kërkojmë qasje objektive, vlerësim konform të arriturave tona, njëjtë sikur për vendet e tjera aspirante drejt BE-së, duke marrë vëmendjen e merituar", ka potencuar ministrja Hoxha përballë pasigurive të ndryshme lidhur me zhvillimet në BE dhe jashtë saj. "Unë e mirëpres vizionin e vendeve kryesuese të Këshillit të BE-së dhe shpreh përkushtimin tim, në emër të institucioneve, për të bashkëpunuar në mënyrë të ngushtë drejt realizimit të vizionit tonë të përbashkët", ka thënë Hoxha.

Më pastaj, me diskutime të pjesëmarrësve u mirëpritën qasjet pozitive ndaj të arriturave të Kosovës, duke marrë edhe përvojat më të mira të procesit integrues nga vendet që tashmë e kanë realizuar atë, si dhe në fuqizimin e sundimit të ligjit, zbatimin e MSA-së me reformat gjithëpërfshirëse, duke e bërë Kosovën të gatshme të bëhet pjesë e vlerave dhe familjes së madhe evropiane.

# Kërkohet drejtësi për të rënët në masakrën e Krushës së Madhe dhe të Vogël

"Epoka e re"

RAHOVEC, 26 MARS - Të martën është shënuar 20-vjetori i masakrave të Krushës së Madhe dhe të Vogël në Komunën e Rahovecit. Në ceremonitë përkujtimore të këtyre masakrave kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj.

Në fjalën e tij, në tubimin përkujtimor në Krushë të Vogël, presidenti Thaçi ka thënë se ky fshat është simbol i mbijetesës. "Sot jemi mbledhur bashkë këtu në Krushë të Vogël, për t'i kujtuar dhe për t'i nderuar 113 martirët dhe dëshmorët e Krushës së Vogël, për t'i kujtuar mbi 13 mijë viktimat e dhunës dhe terrorit të shtetit serb gjatë luftës së viteve 1998-1999. Sot kujtojmë mijëra qytetarë të Kosovës, gra, burra, nëna, baballarë, pleq, të rinj e të reja dhe fëmijë të pafajshëm që u vranë padrejtësisht vetëm pse ishin qytetarë të një etnie të caktuar. Dhunën sistematike të shtetit serb popullata civile e kishte provuar në masakrën e Likoshanit dhe Çirezit që në fillim të vitit 1998, në Abri në vjeshtën e po atij viti, si dhe në Reçak më 15 janar 1999", ka thënë Thaçi.

Pas fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s, Thaçi ka theksuar se forcat policore dhe ushtarake serbe kishin shtuar edhe më shumë krimet, gjenocidin dhe dëbimin e popullatës shqiptare nga Kosova.

Presidenti u ka thënë të pranishmëve në këtë tubim përkujtimor se shumë prej tyre kanë humbur më të dashurit para 20 vjetësh. "Ata, as ju e as ne, nuk do t'i harrojmë kurrë. E dimë që nuk kemi bërë sa duhet, për sa kohë që nuk gjenden dhe identifikohen të gjithë trupat e viktimave, që as sot e kësaj dite nuk kemi arritur t'i sjellim në varrezat e Krushës së Vogël. Personat që i shpëtuan masakrës në Krushë të Vogël dëshmojnë edhe sot me emër dhe mbiemër për autorët e krimeve në uniformë policore dhe ushtarake serbe. Ne nuk do t'i harrojmë asnjëherë krimet e bëra në Krushë të Vogël dhe gjithandej Kosovës. Herët a vonë për to do të jepet përgjegjësi", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se liria që gëzojmë sot është fryt i gjakut dhe sakrificës së martirëve e dëshmorëve tanë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në 20-vjetorin e masakrës në Krushë të Madhe dhe në Krushë të Vogël, të kryer nga forcat serbe mbi popullatën e pafajshme civile




shqiptare, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se këto dy vende janë simbol i një populli që kurrë nuk pranoi të nënshtrohet, duke u bërë kështu simbol i triumfit të jetës mbi vdekjen. Ai ka thënë se ata që urdhëruan dhe kryen masakrën në Krushë të Madhe e Krushë të Vogël, ende janë të lirë, por ka theksuar se kjo nuk do të harrohet kurrë. "Kanë kaluar 20 vjet nga ky krim çnjerëzor. Ne nuk do të ndalemi asnjëherë derisa drejtësia të vendoset për këto fshatra martire të Kosovës. Serbia një ditë duhet të përgjigjet për krimet e kryera në Kosovë. Dhe ajo ditë do të vijë gjithsesi, sepse krimet nuk vjetërsohen dhe drejtësia është e domosdoshme", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël janë simbol i sakrificës sonë për liri.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se përulet para dhimbjes dhe sakrificës së të gjithë të rënëve për liri në Krushë të Madhe dhe Krushë të Vogël.

Haradinaj, pasi ka bërë homazhe te varret e martirëve të rënë nga Krusha e Madhe, dhe duke i kujtuar 63 qytetarë që ende figurojnë të zhdukur, ka thënë se në vitin 1999 ishte e drejtë ndërhyrja e NATO-s për t'u ndalë tragjedia e popullit të Kosovës. "Ashtu si populli i Kosovës, edhe bijë e bija të popujve të tjerë, të NATO-s, u bënë bashkë dhe ndalën të keqen. NATO-ja, e prirë nga Amerika, pikërisht e ndali tragjedinë që i ndodhte popullit të Kosovës", ka thënë Haradinaj në tubimin përkujtimor në nderim të 241 viktimave të Krushës së Madhe. Ai ka thënë se shumë politikanë në Serbi e mohojnë atë që ka ndodhur në Kosovë, por kryeministri ka theksuar se nuk është rruga përpara duke e mohuar këtë dhimbje dhe këto krime.

Kryeministri Haradinaj, pas Krushës së Madhe, ka marrë pjesë edhe në tubimin përkujtimor në nderim të 113 viktimave të Krushës së Vogël, me ç'rast ka thënë se në Krushë të Vogël është një plagë e madhe. Haradinaj të martën ka bërë homazhe edhe te pllaka përkujtimore për viktimat e familjes Berisha në qytetin e Suharekës.





# FSK-ja fillon punën për çminimin e zonave të kontaminuara me mjete eksplozive

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

HANI I ELEZIT, 26 MARS - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Kompania e Çminimit, në bazë të planit të veprimit për vitin 2019, ka filluar sezonin veror të çminimit, duke pastruar zonat e minuara nga dora e njeriut si dhe ato të kontaminuara me bomba kasetore nga ajri. Për mbarëvajtjen dhe fillimin me sukses të këtyre operacioneve, FSK-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme.

Operacionet e para të çminimit për këtë vit FSK-ja i ka filluar në lokacionin e Soqishtës, Komuna e Hanit të Elezit, për të vazhduar më pas me Komunën e Ferizajt, përkatësisht lokacionin "Parku i Lirisë" dhe hapësirën e kazermës "Skënderbeu" të FSK-së, si dhe lokacionin Babaj i Bokës në Komunën e Gjakovës.

Përveç operacioneve të çminimit, FSK-ja ka dy njësi të për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), gjithherë të gatshme 24 orë për shtatë ditë të javës, për largimin e mjeteve të rrezikshme. Këto njësi kujdestare reagojnë në çfarëdo kohe sapo qytetarët të njoftojnë për praninë e këtyre mjeteve. Deri me tani njësitë e EOD-së kanë intervenuar në 2 700 raste dhe kanë demoluar 4 350 mjete të ndryshme eksplozive.



Kompania e Çminimit e Forcës së Sigurisë të Kosovës, pas përfundimit të sezonit të çminimit në fund të nëntorit të vitit 2018, gjatë periudhës së dimrit është përkujdesur për rifreskimin e njohurive të pjesëtarëve, duke organizuar trajnime në fusha të veçanta, si dhe ka organizuar mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës, për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i minave dhe mjeteve të tjera eksplozive.

Prej që FSK-ja ka filluar operacionet e çminimit, nga viti 2010 njësitë e saj kanë pastruar 29 lokacione, me një sipërfaqe prej 2 191 201 metrash katrorë dhe kanë gjetur 3 512 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera. Që nga koha e luftës e deri më sot, 117 veta kanë humbur jetën si pasojë e minave dhe mjeteve të tjera eksplozive, ndërsa 467 të tjerë janë lënduar.

# Subvencionet e drejtpërdrejta të qymyrit në Kosovë, më të lartat në rajon

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 MARS - Subvencionet për nxjerrjen e qymyrit dhe prodhimin e energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor i japin qymyrit një avantazh të padrejtë ndaj burimeve të tjera energjetike më pak ndotëse dhe pengojnë kalimin drejt energjisë së pastër, tregon një studim i publikuar nga Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Sipas studimit, Kosova ka subvencionet më të larta të qymyrit në rajon në krahasim me sasinë e energjisë së prodhuar.
Shteti i Kosovës ka shpërndarë 66.77 milionë euro për industrinë e qymyrit gjatë periudhës 2015-2017, ose një mesatare prej 22.26 milionë eurosh, duke vazhduar kështu përjetësimin e varësisë së vendit nga qymyri. Ndërsa nuk është subvencionimi më i lartë në rajon në terma absolutë, ajo është më e larta për njësi të prodhuar të energjisë elektrike, e barabartë me 4.15 euro për megavat orë. Subvencionet kanë përfshirë transferimet e drejtpërdrejta nga buxheti, heqjen e borxheve, huat nga buxheti dhe sigurimin e garancive të huave shtetërore.
Në tërësi, vendet e Ballkanit Perëndimor mbështetën nxjerrjen e qymyrit dhe prodhimin e energjisë elektrike me subvencione publike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që arrijnë pak më shumë se 1.2 miliard euro midis vitit 2015 dhe 2017, sipas studimit me titull: Analiza e Subvencioneve të Drejtpërdrejta dhe të Përzgjedhura të Tërthorta në Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Qymyri për Palët Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, i cili mbulon Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainën. Gjithashtu, Kosova siguroi një subvencion të tërthortë për industrinë e saj të qymyrit me vlerë 114.5 milionë euro vetëm në vitin 2017, duke mos aplikuar një çmim të karbonit për çdo ton $CO_2$ të emetuar në atmosferë.
Megjithatë, këto pagesa do të duhet të bëhen kur Kosova të hyjë në BE dhe me shumë gjasa që edhe më parë, duke e bërë qymyrin një zgjedhje të keqe si ekonomikisht ashtu edhe ekologjikisht. Në vend që të zvogëlohet, subvencionet në sektorin e qymyrit të Kosovës duket se do të rriten në vitet e ardhshme nëse projekti i diskutueshëm Kosova e Re shkon përpara.
Sipas kontratave të nënshkruara me "Contour Global", Qeveria e Kosovës jo vetëm që do të blejë të gjithë energjinë elektrike nga ky termocentral i planifikuar, por do të siguronte edhe pagesa kur nuk do të operonte, si dhe me garanci të shumta për kompaninë "Contour Global".
Komuniteti i Energjisë ka shprehur tashmë shqetësime se kontratat mund të falimentojnë edhe vendin pasi do të rezultonin me kosto të lartë për konsumatorët dhe/ose subvencionet nga Qeveria, ndërsa "Contour Global" do të gëzonte fitim të garantuar dhe pa rrezik.
Kosova, ashtu si edhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është zotuar t'i ndalojë subvencionet e sektorit të energjisë që u japin kompanive të caktuara një avantazh të padrejtë. Ky është një kusht i anëtarësimit në Komunitetin e Energjisë dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në.
Kosova kërkohet ta vlerësojë pajtueshmërinë e propozuar të subvencioneve me rregullat e BE-së, e një gjë e tillë bëhet nga Komisioni për Ndihmë Shtetërore, i cili u votua nga Kuvendi i Kosovës më 7 mars 2019.
Duke komentuar mbi studimin, Visar Azemi, drejtor i "Balkan Green Foundation", ka thënë se Qeveria e Kosovës po i jep subvencione sektorit të thëngjillit sikur të ketë para për të humbur. "Çdo cent që shkon në sektorin e qymyrit është një cent që duhet të shkojë në spitale, shkolla, furnizim me ujë ose efiçiencë të energjisë. Është koha që Kosova ta bëjë funksional Komisionin për Ndihmë Shtetërore - jo vetëm sepse është një detyrim ndërkombëtar, por sepse pengon humbjen e fondeve publike", ka thënë Azemi.



# Guvernatori Mehmeti diskuton me studentët për zhvillimet e fundit në sektorët financiarë



Mitrovicë, 26 mars - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka mbajtur një ligjëratë para studentëve të Universiteti të Mitrovicës "Isa Boletini" në kuadër të aktiviteteve të Javës Ndërkombëtare të Parasë, në funksion të edukimit financiar.
Guvernatori Mehmeti para studentëve dhe stafit akademik ka prezantuar zhvillimet e fundit në të gjithë sektorët financiarë, me theks të veçantë në sektorin bankar, i cili vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe likuid. "Vlera e gjithsej mjeteve të sektorit bankar në janar të vitit 2019 arriti në 4.163 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.6 përqindësh krahasuar me janarin e vitit 2018. Gjithsej kreditë (bruto) në janar të vitit 2019 ishin në shumë prej 2.75 miliardë eurosh, të cilat shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqindësh. Gjithsej depozitat në janar të vitit 2019 evidentojnë 3.348 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.4 përqindësh. Treguesi i kredive joperformuese ishte në normën prej 2.6 përqindësh në janar të vitit 2019 nga 3.1 për qind sa ishte në janar të vitit 2018", ka thënë guvernatori Mehmeti, duke shtuar se aktualisht depozituesit janë të siguruar për secilën bankë anëtare deri në shumën e siguruar prej 5 000 eurosh. Ai ka thënë se BQK-ja luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## Sekretari Halimi merr përkrahje nga Banka Botërore për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë

UASHINGTON, 26 MARS (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kapllan Halimi, bashkë me ushtruesin e detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, Ekrem Gjokaj, gjatë vizitës zyrtare në Uashington janë duke marrë pjesë në konferencën e Bankës Botërore mbi tokën dhe varfërinë, në të cilën janë prezantuar hulumtimet dhe inovacionet më të fundit në politikat dhe praktikat e mira të qeverisjes së tokës në të gjithë botën. Në kuadër të kësaj vizite sekretari Halimi është takuar me drejtorin e lartë të Bankës Botërore, Juergen Voegele, me të cilin kanë diskutuar për hapat konkretë që mund të ndërmerren në të ardhmen e afërt, me qëllim të zhvillimit më të madh të sektorit të bujqësisë në Kosovë, e për çka Banka Botërore do ta ofrojë mbështetjen e saj. Gjatë këtij takimi Halimi e ka njoftuar atë për të arriturat dhe sfidat në bujqësi në Kosovë.



# Gjilani ndalon kurset private në shkollat publike

GJILAN, 26 MARS (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan përmes një urdhërese ka ndaluar mbajtjen e kurseve private brenda dhe jashtë institucioneve edukativo-arsimore me nxënës që mësimdhënësi i mëson. Me këtë rast, parandalohet imponimi për blerjen e mjeteve, marrje e mitos nga nxënësit, prindërit apo nga të tjerët për përmirësim të notave, kalim klase, dhënie provimi apo forma të tjera të ngjashme me qëllim të përfitimit material. Kjo urdhëresë është mbështetur në rregulloren nr. 016-58780 mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punonjësve në IEA në Komunën e Gjilanit.


DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 25.03.2019 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | Drejtorët e Institucioneve Edukativo - Arsimore - Gjilan |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Drejtori Komunal i Arsimit, Nazim Gagica |
| TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: | URDHËRESË |

Duke u mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësit e DKA-së, si dhe bazuar në Rregulloren nr.016-58780 mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punonjësve në IEAA në Komunën e Gjilanit, Drejtori Komunal i Arsimit, me datë 25.03.2019, lëshon këtë:

URDHËRESË

1. Ndalohet rreptësishtë mbajtja e kurseve private brenda dhe jashtë institucionit edukativo arsimor me nxënës që mësimdhënësi i mëson (nxënësit e vet), imponimi për blerjen e mjeteve, marrja e mitos nga nxënësit, prindërit apo nga të tjerët për përmirësim të notave, kalim klase, dhënie provimi apo forma të tjera të ngjashme me qëllim të përfitimit material.
2. Obligohen drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit e të gjitha niveleve të IEAA për zbatimin e Urdhëresës në fjalë.
3. Për moszbatimin e Urdhëresës, do të merren masa adekuate sipas Rregullores nr.016-58780, neni 8, suspendimi i përkohshëm, ulje-degradim të pozitës, transferim në shkollë tjetër brenda nivelit dhe jashtë nivelit të institucionit edukativo arsimor dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me këtë rregullore, kontratën kolektive dhe kontratën e punës.
4. Kjo Urdhëresë fillon të zbatohet menjëherë me rastin e nënshkrimit të saj.



# Përkujtohen tre dëshmorët dhe njëmbëdhjetë martirët e fshatit Vitak

SKENDERAJ, 26 MARS (ER) - Në 20-vjetorin e rënies, janë përkujtuar tre dëshmorët dhe njëmbëdhjetë martirët e fshatit Vitak të Skenderajt. Në përkujtim të tre dëshmorëve Zeqir e Isuf Malaj dhe Ismet Spahiu, si dhe të 11 martirëve të fshatit Vitak, është mbajtur edhe një akademi përkujtimore. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se sot kujtojnë e respektojnë të gjithë dëshmorët dhe martirët që gjaku i tyre është bërë liri për Kosovën. "Muaji mars sjell në vëmendjen tonë sakrificën e popullit tonë për lirinë e vendit, për lirinë e kësaj toke për të cilën breza të tërë sakrifikuan jetën dhe dhanë gjithçka që patën, vetëm për të mos duruar pafundësisht robërinë. Lufta e popullit shqiptar pothuajse na mori gjithçka që kishim, por kurrë nuk u dorëzuam në rrugëtimin tonë drejt lirisë së vendit. Pasi që lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë dhe e pastër, u pagua me jetë kjo liri, ranë dëshmorë shumë burra të zotë të atdheut dhe të tillë ishin edhe dëshmorët Zeqir e Isuf Malaj dhe Ismet Spahiu", ka thënë Jashari.

Të pranishmëve në këtë akademi u është drejtuar edhe vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari, i cili ka thënë se po përkujtojnë ata që ranë për lirinë që sot e gëzon populli i Kosovës. Ndërsa deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka thënë se dëshmorët dhe martirët duhet të kujtohen çdo ditë për të mos u harruar gjaku i derdhur për liri.



# Kompania 'HPC AG' mbështet studentët e UMIB-it

MITROVICË, 26 MARS (ER) - Studentët e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) janë duke përfituar nga projektet e bashkëpunimit të Universitetit me kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Edona Sadriu, studente e nivelit master në programin Inxhinieri Mjedisore të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, me mbështetje të kompanisë lidere në botë sa i përket inxhinierisë mjedisore "HPC AG", do ta kryejë praktikën në zyrën e Kriftelit në Frankfurt të Gjermanisë me mbështetje financiare të kompanisë. Kjo ka ndodhur pas përfundimit të projektit trevjeçar "Menaxhimi i Zonave të Kontaminuara" të përkrahur nga Deutsche Gesellschaftfür Internationale Zusammenarbeit (GIZ-i) dhe implementuar nga kompania "HPC AG" në bashkëpunim me UMIB-in.

Studentja që ka përfituar në kuadër të këtij projekti ka nënshkruar kontratën në prani të dekanit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, prof. dr. Milaim Sadiku dhe Ali Ahmetit, drejtor i kompanisë "HPC AG" për Ballkan.

Dekani Sadiku e ka vlerësuar lart bashkëpunimin me këtë kompani si dhe projektin e realizuar sa i përket menaxhimit të zonave të kontaminuara. Ndërsa drejtori Ahmeti tha se kompania është e interesuar që njohuritë e ekspertëve me renome botërore t'i bartë te të rinjtë e të rejat e Kosovës, e sidomos te studentët e UMIB-it.

Ndryshe e gjithë kjo mbështetje, sipas tij, është si rezultat i bashkëpunimit profesional në mes të kompanisë dhe UMIB-it, por edhe si rezultat i angazhimit të dr. Christoph Olk, njërit nga drejtuesit e projektit në fjalë, i cili aktualisht është menaxher i Zyrës së "HPC AG" në Kriftel të Gjermanisë.

# Fillon realizimi i vizitave sistematike shëndetësore në shkollat e Shtimes

SHTIME, 26 MARS (ER) - Drejtori i Arsimit, Mensur Neziri dhe ai i Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale në Komunën e Shtimes, Labinot Beqa, në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), kanë filluar të martën realizimin e vizitave sistematike mjekësore për nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta të kësaj komune.

Qëllimi i këtyre vizitave është monitorimi i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të grupmoshave të caktuara, zbulimi i hershëm i patologjive dhe ndërmarrja e masave për korrigjimin e anomalive. Këtë vit vizitat sistematike do të jenë të organizuara në bashkëpunim me dy drejtoritë e Komunës së Shtimes, duke ndihmuar dhe përkrahur QKMF-në, që ka bërë të mundur që këtë vit të fillojmë digjitalizimin e vizitave sistematike dhe futjen e të dhënave në kartelat shëndetësore elektronike.



# Krimi e gjenocidi serb në Kosovë, dëshmi e sundimit ilegal të Serbisë në Kosovë



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Njëzet e gjashtë marsi shënon kulmin e gjenocidit serb në Kosovë. Vrasjet serbe që filluan në Likoshan e Qirez, Abri e Poklek, në Reçak e Ticë, në Krushë e Meje, në Qyshk e Shtedime, në Gjakovë e Suharekë etj., ishin krim e gjenocid i planifikuar dhe i programuar jo vetëm pas viteve 1912/1913. Kur kihet parasysh kjo, nga fjalori ynë i përditshëm duhet ta largojmë fjalën masakër, pasi ajo nuk e mbulon krimin e gjenocidin e kryer mbi shqiptarët dhe jo vetëm gjatë luftës së fundit.

Pse regjimet serbe në Beograd silleshin kështu?

Përgjigjja më e shkurtër do të ishte: pse ishin regjime ilegale. Për 86 vjet me radhë regjimet serbe në Beograd (të gjitha format e regjimeve), e dinin se qëndrimi i tyre në Kosovë ishte ilegal dhe për ta legalizuar atë qëndrim, ata duhej t'i zhduknin pjesërisht ose tërësisht shqiptarët. Këtu dhe vetëm këtu duhet t'i kërkojmë rrënjët e krimit e të gjenocidit serb në Kosovë.

Sot në Botë ka individë e shtete që ndërhyrjen humanitare të NATO-s në Kosovë e quajnë ilegale dhe thirren në të drejtën ndërkombëtare?! Po cili ligj ndërkombëtar e amniston krimin e gjenocidin që një shtet ushtron mbi qytetarët e tij? Të thuhej kjo, para 22 korrikut të vitit 2010, ndoshta edhe mund të arsyetoheshin, por të thuhet pas verdiktit të GjND-së, i cili tha se: Pavarësia e Kosovës nuk bie në ndeshje me të Drejtën Ndërkombëtare, kjo do të thotë se të gjitha mjetet që janë përdorur për të ardhur te Pavarësia e Kosovës kanë qenë e janë legjitime. Janë legjitime se e kanë shpëtuar një popull nga krimi e gjenocidi serb i përsëritur më se një herë gjatë 86 vjetëve të qëndrimit ilegal të Serbisë në Kosovë.

Edhe një herë duhet të konfirmojmë, edhe me zërin e të gjitha viktimave të krimit e të gjenocidit serb në Kosovë, se Serbia për 86 vjet ishte ilegale në Kosovën shqiptare e jo bombardimet e NATO-s mbi reagimin kriminal e gjenocidal të Serbisë!

Të gjithë në Kosovë, e sidomos familjet që u goditen nga krimi e gjenocidi serb, duhet të ngrohen me rrezet e diellit të lirisë, e cila liri nuk mund të vinte ndryshe!

I përjetshëm qoftë kujtimi për martirët dhe dëshmorët e kombit!

# 30 vjet nga demonstratat më të përgjakshme dhe heroike të marsit '89

*- Rënia heroike e dëshmorëve thërret për sendërtimin e plotë në vepër të amanetit të tyre*

Besart KRASNIQI

Tri dekada nga demonstratat e përgjakshme të 27 marsit të vitit 1989 dhe kujtesa liridashëse shqiptare për këtë rezistencë dhe sakrificë të madhe ka mbetur e freskët në mendjet dhe zemrat tona, në të cilat ra në fushën e nderit dëshmori i kombit Ismet Krasniqi. Ishin këto demonstratat më të përgjakshme në historinë e Kosovës, njëkohësisht edhe më heroiket. Demonstruesit shqiptarë treguan se më e shtrenjtë ishte liria sesa jeta nën robëri. Ata, edhe duke u kacafytur me bishat karpatiane fytafytas, treguan se mllefi shqiptar vetëm sa shtohej kundër okupimit serbosllav të Kosovës, në mënyrë që ajo njëherë e përgjithmonë të çlirohet dhe që shqiptarët të vetëvendosin për të ardhmen e tyre.

Në programet për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe popullimin e saj me kolonët serbo-malazezë, antishqiptarët Vasa Çurbilloviq, Ilija Garashanin, Rankoviq, Milosheviq etj. kaherë kishin bërë planet djallëzore duke e orientuar tehun ndaj kombit tonë deri edhe në shfarosjen fizike. Por ishte rinia shqiptare në veçanti, dhe populli në përgjithësi, që nuk lejuan të realizoheshin planet fashiste të kriminelëve serbo-çetnikë, duke u organizuar vazhdimisht për ta bërë të paqëndrueshëm praninë e forcave okupatore në Kosovë dhe për çlirimin e saj deri në bashkimin përfundimtar kombëtar, siç ishte amaneti i dëshmorëve dhe është edhe vullnet i popullit tonë liridashës.

Kështu ndodhi edhe në demonstratat e 27 marsit të vitit 1989, me ç'rast demonstruesit sypatrembur dëshmuan se kur jemi të organizuar dhe të vendosur në kauzën tonë të drejtë, edhe pse përballë kishim një makineri të tërë forcash policore-ushtarake serbo sllave, e pajisur me armatimin më të rëndë, mund t'ia dalim. Pra, siç u pa në vazhdimësi, gjatë përpjekjeve për kauzën tonë të madhe, u vërtetua se vetëm bashkimi bënë fuqinë, siç ndodhi edhe në përballje me një shtet artificial 22 milionësh të quajtur "Jugosllavi". Demonstratat e '89-s sikur ato të '68-s, të '81-shes, të '97-s ishin pararendëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryekomandantit legjendar Adem Jashari dhe komandantit të shquar Zahir Pajaziti.

Dëshmori i kombit Ismet Krasniqi, gjatë shërbimit ushtarak që shkoi më 1979, organizoi edhe takime me bashkëmoshatarët shqiptarë për të diskutuar për rrugëdaljen e popullit shqiptar nga kaosi dhe padrejtësia, për çka edhe merret në pyetje dhe burgoset me urdhrin e oficerëve serbo-jugosllavë, për të shijuar kështu 60 ditë izolim në burgun ushtarak të Karllovcit dhe të Zagrebit të Kroacisë, me ç'rast edhe ushtrohet dhunë ndaj tij. Ndërkohë që gjatë qëndrimit të satrapit Tito atje, Ismeti sërish arrestohet, duke u mbajtur i izoluar.

## Si u zhvillua demonstrata në Prishtinë

Ishte viti 1981. Ismet Krasniqi çdoherë prin në organizimet e demonstratave me të rinjtë e ilegales në lagjen ish-Vranjevci dhe më gjerë, duke vërshuar drejt qendrës së Prishtinës. Ishte i pranishëm edhe në organizimin e shumë demonstratave nëpër qytete të tjera të Kosovës, si në ish-Podujevë (tani Besianë), Ferizaj etj. Në manifestimin e organizuar nga autoritetet komunale më 1982, Ismeti si një i ri entuziast dhe trim shqiptar e shqyen flamurin 'jugosllav' dhe, duke vrapuar, në të njëjtën shtizë e vendos flamurin kombëtar shqiptar, për çka edhe arrestohet të nesërmen në vendin e punës dhe prapë dënohet me 60 ditë burgim, të cilat i vuan në burgun e Prishtinës, Ferizajt dhe Mitrovicës. Në lagjen ish-Vranjevci dhe në tërë qytetin e Prishtinës, ai përherë është aktiv me afishe, parulla dhe thirrje për liri dhe ribashkimin e popullit shqiptar në një Shqipëri.




Në një fjalim të njohur gjatë një proteste të organizuar në Prishtinë, gjashtë muaj para se të bjerë dëshmor, Ismeti hapur dhe pa u hamendur, duke dëshmuar edhe një herë trimërinë dhe patriotizmin e tij, në prani të forcave policore serbo-sllave kërkon Republikën për Kosovën, duke theksuar se gjaku i dëshmorëve të rënë do të jetë një bazament i fuqishëm në themelet e lirisë së saj.

Edhe fillimi i vitit 1989 Ismetin e gjen në aksionin për shpërndarjen e parullave dhe afisheve përmes të cilave i bëhet thirrje popullit për zgjim.

Më 22 mars 1989 Ismetin e marrin në të ashtuquajturën "bisedë informative" ku e kërcënojnë edhe me likuidim. Mirëpo ai nuk e ndal veprimtarinë atdhetare. Madje, ua thotë haptas inspektorëve të UDB-së, se nuk do të pushojë së vepruari për kauzën kombëtare shqiptare me asnjë çmim.

Ndërsa, më 26 mars, pra një ditë para demonstratave më të përgjakshme që kanë ndodhur ndonjëherë në Kosovë, ai sërish gjendet në krye të organizimit të demonstratave në Vranjevc, duke ftuar të rinjtë e kësaj lagjeje kryengritëse për një demonstratë edhe më të fuqishme të nesërmen kundër Serbisë okupatore që do të mbahej në Prishtinë.

27 mars 1989. Ndërsa gjendet në ballë të demonstruesve në qendrën e qytetit, duke iu prirë bashkë me shokë, diku rreth orës 15:10, Ismetin u munduan ta arrestonin nja katër inspektorë të UDB-së. Mirëpo zhdërvjelltësia e tij bëri që ata mos t'ia arrinin. Masa e popullit, e gatshme për të demonstruar kundër okupimit serb, sa vinte e shtohej, e cila, me të filluar demonstrata, has në kordonët policorë serbo-jugosllavë, që provojnë ta shpërndajnë turmën me ndërhyrje fizike dhe përmes gazit të shumtë lotsjellës. Në këtë përleshje në mes të demonstruesve duarthatë dhe policëve të armatosur deri në dhëmbë, Ismeti me shokë nuk ndalet duke iu prirë masës dhe duke brohoritur për liri dhe fitore. Duke brohoritur për lirinë dhe Republikën e Kosovës me entuziazëm, është ora rreth 17:30 e të njëjtës datë, në rrëmujën e demonstratave që shkaktohej edhe nga të shtënat e armëve, ai nuk ndalet, por thërret duke ngritur dorën: "Përpara shokë deri në fitore!" Dhe nga një autoblindë, dëshmori Ismet Krasniqi qëllohet me snajper nga një serbo-çetnik, duke rënë heroikisht në fushën e nderit për të mos vdekur kurrë. Ideali i tij dhe i të gjithë dëshmorëve të tjerë kurrë nuk do të harrohen, por do të kujtohet me pietet brez pas brezi. Ndërsa populli shqiptar ka për obligim që të bashkohet dhe të jemi të vendosur në mënyrë që të sendërtojmë në vepër amanetin e dëshmorëve për pavarësi të plotë e sovrane dhe bashkim kombëtar.

Në demonstratat e 27 dhe 28 marsit Kosovë ranë dëshmorë 28 demonstrues shqiptarë si dhe u plagosën e u arrestuan qindra të tjerë, ndërsa vetëm në Prishtinë më 27 mars 1989 ranë dëshmorë Ismet Krasniqi, Vetim Shala, Sevdat Xhafolli, Shukrije Obërtinca dhe Mustafë Veselaj, të cilët në mënyrën më heroike ranë në fushën e nderit.




Sport




# Prishtina kërkon fitoren e parë ndaj Flamurtarit

FC Prishtina, pas një barazimi dhe një humbje nga Flamurtari në këtë kampionat, sot e kërkon fitoren e parë ndaj kësaj skuadre. "Na pret një ndeshje e vështirë. Nuk na lejohet më të gabojmë dhe normalisht synojmë të zhvillojmë lojë të mirë dhe t'i fitojmë tri pikët", ka thënë Armend Thaqi, futbollist i Prishtinës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 MARS - Pas ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, rikthehet IPKO Superliga me ndeshjen e mbetur të javës së 23-të në mes të Prishtinës dhe Flamurtarit. Skuadra e Prishtinës kërkon maksimumin e pikëve në derbin e kryeqytetit, pasi në këtë kampionat ende nuk e ka shijuar fitoren ndaj skuadrës kuqezi. Mbrojtësi Armend Thaqi ka thënë se atmosfera është e mirë në skuadrën e Prishtinës dhe synimi i vetëm është fitorja ndaj Flamurtarit, në ndeshjen që zhvillohet sot (e mërkurë) nga ora 14:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". "Po kthehemi nga pushimi më i gjatë sesa i ekipeve të tjera dhe mendoj se na ka bërë mirë para përballjes me kundërshtarin që na ka shkaktuar më së shumti probleme në këtë edicion duke mos arritur ta mposhtim asnjëherë. Na pret një ndeshje e vështirë. Nuk na lejohet më të gabojmë dhe normalisht synojmë të zhvillojmë lojë të mirë dhe t'i fitojmë tri pikët. Atmosferën në skuadër e kemi shumë të mirë, megjithëse kemi probleme me mungesa, duke mos ditur se a do të mund të startojnë disa prej tyre apo jo, për çka do të vendosin trajnerët. Por, e jona është ta japim maksimumin për tri pikët më se të domosdoshme", ka thënë Thaqi për faqen zyrtare të klubit.



Aktualisht Prishtina pozicionohet në vendin e tretë me 47 pikë, kurse Flamurtari është në vendin e nëntë me 28 pikë të grumbulluara. Për derbin ndaj Prishtinës foli edhe portieri i Flamurtarit, Flamur Neziri, i cili në të kalurën e kishte djersitur fanellën "bardhekaltër". "Para vetes e kemi një ndeshje shumë të vështirë, pasi përballemi me Prishtinën. Nëse angazhohemi dhe luajmë me disiplinë mund të nxjerrim rezultat të favorshëm, sikurse që kemi nxjerrë në dy ndeshjet e kaluara. Do të ishim të kënaqur edhe me një barazim në këtë ndeshje, pasi kundërshtari ynë ka cilësi të mëdha", ka deklaruar Neziri, i cili me këtë rast ka konfirmuar se Flamurtari në këtë ndeshje është pa Lorik Maxhunin dhe Gentrit Dumanin. Ndërkohë faqja zyrtare e Klubit të Prishtinës ka njoftuar edhe për çmimin e biletave për këtë ndeshje që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Çmimi për biletat në tribunën lindore është 2 euro, kurse për tribunën perëndimore është 3 euro. Për tribunën VIP kushton 5 euro.

IPKO SUPERLIGA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 23 | 55 |
| 2. Llapi | 23 | 48 |
| 3. Prishtina | 22 | 47 |
| 4. Drita | 23 | 38 |
| 5. Gjilani | 23 | 32 |
| 6. Drenica | 23 | 30 |
| 7. Ballkani | 23 | 29 |
| 8. Trepça '89 | 23 | 28 |
| 9. Flamurtari | 22 | 28 |
| 10. Ferizaj | 23 | 25 |
| 11. Liria | 23 | 24 |
| 12. KEK-u | 23 | 1 |

# Formohet Federata e Badmintonit

"Licencimi i Federatës së Badmintonit tregon edhe një herë përkushtimin tonë për sportin në vend. Theksoj se është obligim yni që t'i përkrahim financiarisht federatat dhe sportistët në vend. Nënshkrimi i këtij memorandumi vjen pas licencimit të kësaj federate së cilës i urojmë suksese dhe të cilën e garantojmë se do të jemi gjithmonë në mbështetje për avancimin e këtij sporti të ri në vendin tonë", ka thënë ministri Kujtim Gashi

PRISHTINË, 26 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim Jeton Nebiun, kryetarin e federatës më të re që u themelua në Kosovë, Federatës së Badmintonit. Me këtë rast, kjo federatë u pajis me licencë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njëherësh në mes të Federatës dhe MKRS-së u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi për përkrahje financiare. Sipas memorandumit të nënshkruar, Federata e Badmintonit të Kosovës mbështetet financiarisht me 35 mijë euro. Mjetet financiare të pranuara Federata do t'i shfrytëzojë për realizimin e politikave programore për vitin 2019 për promovimin dhe avancimin e sportit të badmintonit.

Ministri Gashi ka thënë se puna e tij për avancimin e sportit dhe krijimin e federatave të reja të nevojshme për të rinjtë e vendit nuk do të ndalet me kaq. "Licencimi i Federatës së Badmintonit tregon edhe një herë përkushtimin tonë për sportin në vend dhe theksoj se është obligim yni që t'i përkrahim financiarisht federatat dhe sportistët në vend. Nënshkrimi i këtij memorandumi vjen pas licencimit të kësaj federate së cilës i urojmë suksese dhe të cilën e garantojmë se do të jemi gjithmonë në mbështetje për avancimin e këtij sporti të ri në vendin tonë", ka thënë ministri Gashi.



Ndërkaq kryetari Jeton Nebiu e falënderoi ministrin Gashi për licencimin e Federatës dhe për nënshkrimin e memorandumit duke e cilësuar shumë të nevojshme përkrahjen financiare nga ana e Ministrisë. Ai, po ashtu, bëri me dije se kjo federatë do të punojë në vazhdimësi për promovimin e këtij sporti të ri dhe për angazhimin e sa më shumë talenteve të rinj në këtë sport.

## Superliga në basketboll sjell dy derbi

PRISHTINË, 26 MARS - Menjëherë pas ndeshjeve të fundjavës, në mesjavë do të luhet xhiroja e 24-t e Superligës së Kosovës në basketboll dhe do t'i sjellë dy derbi. Ponte Prizreni - Bashkimi është dueli me të cilin nis xhiroja e XXIV në Superligën e Kosovës në basketboll, i cili do të zhvillohet të mërkurën me fillim nga ora 19:00 në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren.

Të enjten do të zhvillohet një tjetër ndeshje interesante në mes të Rahovecit dhe Golden Eagle Yllit me fillim nga ora 19:00 në palestrën "Mizahir Isma", kurse Z Mobile Prishtina është nikoqir i AFK Boreas, takim ky që luhet të mërkurën, duke filluar nga ora 19:00. Ndeshja e fundit e xhiros luhet në Mitrovicë, ku Trepça e pret Lipjanin. Pas 23 xhirove të luajtura në elitën e basketbollit kosovar, Z Mobile Prishtina kryeson në renditjen tabelore me 46 pikë, e ndjekur nga Golden Eagle Ylli, Rahoveci dhe Ponte Prizreni.



## Challandesi: Kosova në Evropian nuk është ëndërr e pamundur



PRISHTINË, 26 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka thënë se Liga e Kombeve ishte e suksesshme për Kosovën, kurse pjesëmarrja në Kampionatin Evropian "Euro 2020" është shumë e mundshme. "Liga e Kombeve ishte shumë, shumë e mirë për një vend si Kosova, sepse me këtë ligë ti mund të përfundosh e para në grup dhe pastaj i ke vetëm dy ndeshje, gjysmëfinalen dhe finalen… dy ndeshje dhe mund të bëhesh pjesë e Kampionatit Evropian", ka thënë Challandes në një intervistë për "Optus Sport".

"Kosova, pjesë e Kampionatit Evropian? Pas vetëm katër vjetëve, kjo është e mrekullueshme. Por, nuk është ëndërr e pamundur", ka deklaruar Challandesi.

# Ujkani tregon pse e la Shqipërinë për Kosovën



PRISHTINË, 26 MARS - Portieri dhe kapiteni i Përfaqësues së Kosovës, Samir Ujkani, ka treguar pse e ka zgjedhur Kosovën në një intervistë për rrjetin televiziv australian "Sport Optus". Ujkani e bëri paraqitjen e tij të 20 për Kosovën në ndeshjen miqësore me Danimarkën, po aq sa i ka edhe për ekipin kombëtar të Shqipërisë. Ujkani kishte luajtur edhe për ekipin U-21 të Shqipërisë, ndërsa për ekipin e parë kishte debutuar më 10 qershor të vitit 2009. Gjatë shtatë vjetëve me kuqezinjtë, ai i bëri 20 paraqitje. 30-vjeçari i ka bërë po kaq paraqitje edhe për Kosovën, pasi debutoi më 3 qershor të vitit 2016. Për shumicën e ndeshjeve që atëherë, Ujkani ka qenë titullar për "Dardanët", mirëpo së fundi duket se Arijanet Muriçi e ka zënë pozitën e portierit të parë. "Unë po luaja për Shqipërinë në atë kohë. Isha krenar që po luaja për Shqipërinë, i falënderoj ata gjithmonë dhe ishte një kohë fantastike. Por, kur Kosova e krijoi ekipin kombëtar, për mua ishte si një ëndërr e kthyer në realitet dhe unë isha i pari që e bëra këtë hap", ka thënë Ujkani. "Ishte si një ëndërr… kur isha i vogël, dëgjoja se ne kemi humbur familjarë në luftë dhe e mbaj mend se kur isha i vogël, i kisha thënë babait se do të luajë për ekipin kombëtar të Kosovës, që në atë kohë nuk ekzistonte. Kur ishte lufta, shumë gjëra ndodhën, shumë gjëra të këqija dhe unë mendova se në këtë mënyrë mund të shpaguaj gjithçka, për familjen time dhe për të gjithë njerëzit që luftuan për këtë vend", ka deklaruar Ujkani.

# Fitojnë Memphisi, Portlandi, Orlando dhe Utaha



**Orlando, 26 mars** - NBA vijon të dhurojë spektakël. Duke qenë kampionati më i fortë në botë i basketbollit, të gjithë adhuruesit e këtij sporti janë sy e veshë andej. Në sfidat e radhës befasia ka ardhur nga Memphis Grizzlies, që ka mposhtur Oklahoma City Thundersin me rezultatin 115-103. Emocione edhe në ndeshjen tjetër, ku Portland Trail Blazersi vetëm në pesë minuta ka siguruar triumfin ndaj Brooklyn Netsit. Rezultati përfundimtar ishte 148-144. Utah Jazzi ka kaluar pa probleme Phoenix Sunsin, duke regjistruar rezultatin e thellë 125:92. Orlando Magic është treguar më lart se Philadelphia 76ers, duke fituar 119:98. Kujtojmë se tashmë kanë mbetur edhe tetë ndeshje nga fillimi i fazës "paly-off" në NBA.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Orlando M.-Philadelphia | 119-98 |
| Memphis G.-Oklahoma City Th. | 115-103 |
| Utah J.-Phoenix S. | 125-92 |
| Portland Trail B.-Brooklyn N. | 148-144 |

## SHKURT

### FShF-ja nis negociatat me Besnik Hasin

Kombëtarja e Shqipërisë është në kërkim të trajnerit të ri pas largimit të Christian Panuccit, teksa në skenë ka dalë emri i Besnik Hasit. Ish-mesfushori i shquar është një alternativë serioze për ta marrë drejtimin e kombëtares kuqezi. Aktualisht ai drejton skuadrën e Al-Read në Arabinë Saudite, por i skadon kontrata në muajin maj. Hasi vazhdimisht ka shprehur dëshirën për stolin kuqezi, ndërkohë që në karrierën e tij ai ka fituar titullin si trajner me Anderlehtin dhe ka drejtuar më pas edhe Olimpiakosin dhe Legian e Varshavës. Në listë për ta marrë drejtimin e Shqipërisë janë edhe Edi Reja, De Kanio dhe Roberto Donadoni.

### Sancho nuk largohet nga Dortmundi

Pavarësisht prej zërave për një largim të Jadon Sanchos drejt Manchester United në verë, në shtëpinë e Borussia Dortmundit mbizotëron qetësia. Drejtori sportiv i verdhezinjve, Michael Zorc, në një intervistë përgënjeshtroi gjithçka lidhur me këtë çështje. Drejtuesi i klubit gjerman deklaroi se nuk ka asnjë informacion për një interesim të "Djajve të Kuq" për mesfushorin dhe se ata nuk janë aspak të shqetësuar për këtë çështje. Ai theksoi se më e rëndësishme është që Sancho nuk do të largohet nga skuadra gjatë verës.

### Beckenbaueri kritikon Kovaqin

Bayern Munchen u rikthye në vend të parë të Bundesligës pas më shumë se katër muajsh ndjekje të përjavshme ndaj rivalëve të Borussia Dortmundit. Rikthimi në vend të parë bëri që shumë nga kritikët e kroatit të mbyllnin gojën, por ka ende nga ata që nuk besojnë te 47-vjeçari. Një ndër ta është legjenda e Bayernit dhe Gjermanisë, Franc Beckenbauer, i cili ka kritikuar kroatin në një intervistë për "Sky Sports". "Ka një ndryshim shumë të madh midis të qenit trajner i Bayernit dhe skuadrave të tjera të Bundesligës. Nuk e di a do t'ia dalë Kovaq dhe nëse ai është njeriu i duhur për ta çuar Bayernin përpara. Kur përfundon sezoni, drejtuesit duhet të mendojnë për një plan të ri. Kjo nuk do të ishte diçka e keqe", ka thënë Beckenbauer.

### McGregori njofton tërheqjen nga MMA

Conor McGregor shokon të apasionuarit e UFC-së. Luftëtari irlandez nëpërmjet një postimi të shkurtër në rrjetet sociale ka njoftuar tërheqjen nga MMA (Mixed Martial Arts). 30-vjeçari është i pezulluar për shkak të sherrit me Khabib Nurmagomedov menjëherë pas përballjes me rivalin e tij nga Dagestani në Las Vegas. Pavarësisht prej zërave për caktimin e një tjetër dueli, McGregor i ka lënë të gjithë me gojë hapur. "Përshëndetje djema! Kam vendosur të tërhiqem nga sporti që njihet si MMA (Mixed Martial Arts). U uroj të gjithë kolegëve të mi që të shohin përpara në këtë kompeticion. Tani u bashkohem ish-ortakëve të mi në këtë disiplinë, tashmë në pension", shkroi McGregor në "Twitter".

McGregor nga viti 2013 garonte në Ultimate Fighting Championship (UFC), që konsiderohet liga më e rëndësishme e MMA-së në të gjithë botën. Në fakt, gjatë muajve të fundit, më shumë se për përballjet e tij në ring, është folur për çështjet gjyqësore. Në prill të vitit të kaluar u arrestua në New York, pasi sulmoi disa kolegë, ndërsa në tetor u pezullua 6 muaj për shkak të përplasjes me Khabib Nurmagomedov dhe stafin e tij fill pas duelit në La Vegas. Ndërsa pak ditë më parë u ndalua nga policia në Miami, pasi i kishte thyer telefonin një personi që dëshironte të bënte një foto me të.

### Reali interesohet për Pjaniqin

Skuadra e Real Madridit po e monitoron mesfushorin e Juventusit, Miralem Pjaniq, njofton "Diario AS". Sipas gazetës spanjolle, Reali është i gatshëm t'i paguajë Juventusit një dëmshpërblim prej 80 milionë eurosh për Pjaniqin, i cili pëlqehet nga trajneri Zinedine Zidane. 28-vjeçari verën e shkuar ka firmosur kontratë të re me Juventusin, e cila do ta mbajë te ekipi italian deri në vitin 2023. Ai është pjesë e Juventusit prej vitit 2016, kurse karrierë ka bërë edhe te Roma, Lyoni e Metzi.

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI**

**VENDI - Kosovë**

**EMRI I PROJEKTIT- Projekti i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport**

**Nr. i kreditit: 6035XK**

**Nr. identifikues i projektit: 152881**

**TITULLI I DETYRËS: Vlerësimi dhe përgatitja e propozimit për renovimin e Ndërtesës së Agjencisë së Metrologjisë dhe projektimi i sistemit të HVAC-ut ( Nxehje, Ventilim, kondicionin dhe ftohje)**

**Ref.no:MTI/CQ/01/2019** **Date:26/03/2019**

**HISTORIKU**

Qeveria e Kosovës ka punuar me Bankën Botërore për të përgatitur Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (PKGE). Qëllimi i zhvillimit të PKGE është të mbështesë certifikimin e produkteve për tregjet e eksportit, të forcojë kapacitetin e firmave të orientuara nga eksporti dhe të zvogëlojë koston e inspektimit të bizneseve. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve bëhet nga Njësia për Zbatimin e Projektit (NJZP).

PKGE synon që brenda këtij objektivi të forcojë tre institucione themelore: AMK (Agjencia e Metrologjisë së Kosovës), DAK (Drejtoria e Akreditimit) dhe AKS (Agjencia Kosovare për Standardizim). Të tre institutet funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe kanë nevojë për hapësira në formë të laboratorëve modern dhe të sofistikuar, zyra, salla të takimeve si dhe struktura mbështetëse. Një ndërtesë ekzistuese që gjendet në Bërnicë (jashtë Prishtinës), konsiderohet të përdoret për të përmbushur këtë nevojë.

Kjo ndërtesë ("Ndërtesa" këtu e tutje) është përfunduar në vitin 2011 dhe pranuar në vitin 2011 dhe është në pronësi dhe mirëmbahet nga MTI. Ajo asnjëherë nuk është përdorur as funksionalizuar deri tani. Ndërtesa, në parim, ka të gjitha nën-sistemet e nevojshme (elektrike, mekanike dhe HVAC) në përputhje me objektivat fillestare të ndërtimit. Sidoqoftë, meqenëse përdorimi i synuar është ndryshuar dhe meqenëse Ndërtesa nuk është përdorur kurrë, nuk është e qartë se si do të përmbushë kushtet e kërkuara gjendja ekzistuese e Ndërtesës. Gjithashtu nuk dihet gjendja e nën-sistemeve, meqë Ndërtesa nuk është funksionalizuar kurrë.

Qeveria e Kosovës, në kuadër të PKGE, synon të bëjë ndryshimet e nevojshme në Ndërtesë dhe ta bëjë atë funksionale në përputhje me kërkesat e funksioneve të reja të Ndërtesës. Si pjesë e kësaj pune, do të përzgjidhet një kompani e përshtatshme për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të ndërtesës, për testimin e të gjithë nën-sistemeve dhe për përgatitjen e një programi për të bërë modifikimet dhe riparimet e nevojshme (nëse është e nevojshme) që kërkohen për përdorimin e ri të synuar të Ndërtesës.

Tani, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), fton një firmë të kualifikuar profesionale dhe kompetente për të shprehur interesin e tyre për ofrim të shërbimeve.

**OBJEKTIVI I DETYRËS**

